

VENDIM
Nr. 4, datë 21.1.2013

**PËR HEQJEN E LICENCAVE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR
AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 8, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR DHE PËR AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Shqipërisë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008; “Deklaratës rregullatore”, miratuar me vendimin nr. 12, datë 3.3.2009, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për heqjen e licencave”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; licencës “Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, miratuar me vendimet nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; kontratës së furnizimit me energji elektrike me KESH sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje”, të miratuar me vendimin nr. 31, datë 31.3.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; marrëveshjes së transmetimit mes OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” miratuar me vendimin nr. 3, datë 11.1.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike për heqjen e licencës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Heqje të licencës së aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.
2. Heqje të licencës së aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.
3. Shoqëria “CEZ Shpërndarje” është përgjegjëse për kostot e shkaktuara ERE-s, Qeverisë Shqiptare dhe pjesëmarrësve të tregut, si rezultat i heqjes së licencave në përputhje me pikën 5.6 të licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pikës 5.6 të licencës së furnizimit publik me pakicë.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë Këshillin e Ministrave për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, që të veprojë për shpronësimin e aseteve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.
5. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë “CEZ Shpërndarje” për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani